

Vendim nr. 121 datë 06.06.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 06.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (SH) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **SHPËTIM MEMA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. (11-2016-1467) 405, datë 30.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 10-2017-826 (259), datë 11.04.2017 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2022-1397, datë 08.11.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 29, pika 2, 42, pika 2 dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 17 dhe 18 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (KP); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është akuzuar për veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 79, shkronja “dh” dhe 22 të KP-së, si dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278/2 i po këtij kodi (përpara ndryshimit me ligjin nr. 144/2013), të lidhur me ngjarjen e ndodhur në datën 04.07.2014.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2016-1467) 405, datë 30.03.2016, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese” mbetur në tentativë, të parashikuara nga nenet 79, shkronja “dh” “Vrasje me dashje e kryer: dh) kundër dy ose më shumë personave, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet” dhe nenit 22 “Kuptimi i tentativës” të K.P-së, dhe dënimin e tij me 22 vite burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga neni 278/3 i K.P-së (përpara ndryshimit me ligjin 144/2013) dhe dënimin e tij me tre vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të K.P-së, në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit me 22 vjet burgim”.*

3. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim, duke pretenduar se nga hetimi i ngjarjes nuk rezultojnë prova bindëse për autorësinë e veprës penale nga kërkuesi. Ai ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe deklarimin fajtor të tij, vetëm për kryerjen e veprës penale të armëmbajtjes pa leje, të parashikuar nga neni 278, paragrafi 3, i KP-së (përpara ndryshimit me ligjin nr.144/2013).

4. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin 10-2017-826 (259), datë 11.04.2017, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit penal nr. (11-2016-1467) 405, datë 30.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për sa i përket deklarimit fajtor të pandehurit, cilësimit juridik të veprave penale të parashikuar nga neni 79/dh e 22 të Kodit Penal, masave të dënimit për secilën vepër penale edhe atë përfundimtar me këtë ndryshim. Deklarimin fajtor të pandehurit për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit” të parashikuar nga neni 287/2 i K.P-së, para ndryshimit me ligjin 144/2013”.*

5. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar rekurs, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve nr. (11-2016-1467) 405, datë 30.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe nr. 10-2017-826 (259), datë 11.04.2017 të Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe pushimin e çështjes, me arsyetimin se nuk vërtetohet fajësia e tij.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1397, datë 08.11.2022, bazuar në nenet 433 dhe 441, pika 1, shkronja “a”, të Kodit të Procedurës Penale (KPP) ka vendosur

mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se asnjë nga pretendimet e ngritura në të nuk u referohen shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Kolegji gjithashtu ka arsyetuar se nuk rezulton të ketë shkaqe për cenimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës dhe se pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve dhe provave nga gjykatat e faktit, për të cilat Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, nuk ka juridiksion.

7. Në datën 07.03.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, sipas objektit të saj.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi** ka pretenduar cenimin e së drejtës për *proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi gjykatat duhej të aplikojnë zbutjen e dënimit në kushtet kur ai ndodhej në pozitë të parashikuara në nenin 17 të KP-së, i cili normon rastet e papërgjegjshmërisë, për shkak të gjendjes mendore, kur personi gjatë kryerjes së veprës penale vuan nga turbullime psikike ose neuropsikike, të tilla që i krijojnë pamundësi në kontrollin e veprimeve, për rrjedhojë nuk mund të kuptojë se po kryen vepër penale, si dhe nenit 18 të po këtij kodi, i cili normon kryerjen e veprës penale dhe rastet e zbutjes së dënimit të personit që kryen vepër penale në gjendje të dehur në rrethana të rastit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

10. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto

kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, pra mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuksi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Duke analizuar respektimin e këtyre kritereve në rastin konkret, vlerësohet se kërkuksi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në gjykimin për të cilin janë dhënë vendimet gjyqësore, objekt kundërshtimi në Gjykatën Kushtetuese.

12. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 08, datë 19.03.2018; nr.31, datë 25.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, rezulton se për procesin në fjalë kërkuksi u është drejtuar të gjitha shkallëve të gjykimit, duke paraqitur kundërshtimet e tij në lidhje vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se kërkuksi i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000.

14. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, Kolegji konstaton se kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 07.03.2023, ndërsa vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i datës 08.11.2022. Për rrjedhojë, kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

15. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, kërkuksi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhej të aplikonin zbutjen e dënimit, duke qenë se në momentin e kryerjes së veprës penale, ai ndodhej në pozitë të parashikuara në nenet 17 dhe 18 të KP-së, pra në gjendje të dehur rastësore dhe i turbulluar nga ana psikike. Sipas tij, gjendja e dehjes tregon qartë se ka pasur turbullim të tillë që i ka prishur tërësisht ose

pjesërisht ekuilibrin mendor. Nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ky fakt nuk është marrë për bazë gjatë kryerjes së veprës penale.

16. Gjykata ka theksuar se roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 5, datë 01.03.2018; nr. 23, datë 20.04.2016; nr. 3, datë 19.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Interpretimi i ligjit, duke përcaktuar përmbajtjen e tij, është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 2 datë 11.02.2021; nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 1, datë 20.01.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në kontekst të standardeve të mësipërme, Gjykata ka vlerësuar, gjithashtu, se dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, nga njëra anë, dhe shkallës së fajit të autorit të saj, nga ana tjetër. Në këtë drejtim, individualizimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale (*shih vendimet nr. 12, datë 19.03.2015; nr. 47, datë 27.06.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuuesi nuk ka arritur ta ngrejë pretendimin e tij në nivel kushtetues. Nisur nga fakti se pretendime të kësaj natyre nuk bëjnë pjesë në juridiksionin e Gjykatës, por i përkasin juridiksionit të gjykatave të zakonshme, Kolegji vlerëson se kërkuuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* për këtë pretendim.

19. Për sa më lart, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuessit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor është haptazi i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.